

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rokadë në diplomacinë shqiptare/ Meidani dhe Malaj pritet të ndërrojnë postet mes Shkupit dhe Prishtinës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/rokade-ne-diplomacine-shqiptare-meidani-dhe-malaj-pritet-te-nderrojne-p-i588803
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:10:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	19ab31e1894c5701fbd434edd70501e370d167d79607dff6b7d4d1f58950c877
TEKSTI	f224aa4fd2680b68d0def7863e466059c7e0bdc1b08250cce45ec13ebf028e78
PAMJA	571f0a6cf5c633658b65852d0561bc96e4dbd4eb4753bef25e9ac054ebbb736e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1812bffaeca14ec3ddc20efec28cc956e4d00e3f69c5b66591739deff86c9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1812bffaeca14ec3ddc20efec28cc956e4d00e3f69c5b66591739deff86c9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

Çatia e banesës shembet nga rraket, humb jetën 70-vjeçari në FierSkenar lufte/ Lituania teston evakuimin e Vilniusit në rast sulmi, stervitja me e madhe ushtarake për fundit

Rokadë në diplomacinë shqiptare/ Meidani dhe Malaj pritët të ndërrojnë postet mes Shkupit dhe Prishtinës



27 Shtator 2026, 21:00Politika TEMA



Ndryshime pritët të ketë në rangun e ambasadorëve shqiptarë në rajon, teksa Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka çuar përpara procedurat për një rokadë në përfaqësitë diplomatike në Shkup dhe Prishtinë.

Më 9 tetor Komisioni Parlamentar për Punët e Jashtme pritët të zhvillojë dy dëgjesa, ku në fokus do të jenë pikërisht dy emërimet e reja. Ambasadori aktual i Shqipërisë në Shkup, Denion Meidani, pritët të paraqesë platformën e tij për drejtimin e ambasadës shqiptare në Prishtinë, ndërsa ambasadori në Kosovë, Petrit Malaj, pas rreth tre vitesh në këtë detyrë, do të dëgjohet nga komisioni për kandidaturën e tij për të drejtuar misionin diplomatik shqiptar në Shkup.

Bëhet fjalë për një lëvizje që ishte paralajmëruar prej disa muajsh dhe që tashmë ka hyrë në fazën institucionale të shqyrtimit të kandidaturave. Sipas raportimit të Top Channel, mbetet ende e paqartë se çfarë argumentesh përmban relacioni shoqërues i ministrit të Jashtëm, Ferit Hoxha, mbi arsyet që kanë çuar në propozimin për ndryshimin e dy ambasadorëve në këto dy poste të rëndësishme diplomatike.

Rokada e mundshme mes Shkupit dhe Prishtinës nuk është lëvizja e vetme që po kryhet në shërbimin diplomatik shqiptar. Vetëm një javë më parë, Komisioni Parlamentar për Punët e Jashtme zhvilloi dëgjësën me ambasadorin shqiptar në Londër, Uran Ferizi, i cili është propozuar për të marrë drejtimin e Misionit të Shqipërisë pranë OSBE-së në Vjenë.

Ndërkohë, ende nuk është bërë e ditur se kush do të jetë diplomati që do të marrë drejtimin e ambasadës shqiptare në Britaninë e Madhe, duke lënë të hapur një tjetër emërim në kuadër të lëvizjeve që po ndodhin në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë jashtë vendit.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama përjashton dorëheqjen: Askush nuk do të na ndalë, Shqipëria nuk kthehet pas](#)

15:30 Politika / 19 komente

['Kryefaktori i çdo rasti jam unë', Rama i përgjigjet me ironi akuzave të opozitës: Qeveria gjykohet nëse lë drejtësinë të bëjë punën](#)

15:20 Politika / 3 komente

[VIDEO/ Rama: Me paratë e "fabrikës së vdekjes" në Gërdec u ngrit një "lavatriçe mediatike" kundër qeverisë](#)

15:15 Politika / 31 komente

[VIDEO/ "Pisanjosë me kostum parlamentar", Rama: Thonë se mora orë super të shtrenjtë nga krimi! Të gjitha dhuratat i kam regjistruar si pronë të shtetit](#)

15:10 Politika / 37 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.